



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Ligjshmërisë**

|          |  |
|----------|--|
| Data     |  |
| Nr. Prot |  |

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**  
**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 5.12.2020, TË KOMISIONIT**  
**RREGULLATOR, "PËR ÇAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE TRAJNIMIT TË**  
**SHTETASVE QË MUND TË EMËROHEN KRYESISHT PËR PLOTËSIMIN E VAKANCave NË KZAZ**  
**DHE KQV"**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI**

Neni 20, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

**II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT**

Projektakti përmban disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, "Për çaktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancave në KZAZ dhe KQV".

Këto ndryshime vijnë si nevojë për të adresuar më mirë kompetencat që Kodi Zgjedhor u njeh Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe, në zbatim të nenit 14 të Kodit Zgjedhor, Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në lidhje me garantimin e së drejtës për të mbikëqyrur procesin e rekrutimit të zyrtarëve zgjedhorë.

Në këtë rast, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka detyrimin t'u vendosë në dispozicion Komisionerit dhe Nënkomisionerit, krahas raportit për rezultatet e verifikimit të të dhënave të shtetasve që kanë shprehur interes për t'u emëruar kryesisht në KZAZ dhe në KQV, edhe dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo kandidat që ka shprehur interes.

Njëkohësisht, projektvendimi propozon heqjen nga akti në fuqi të parashikimit për Zyrat Rajonale Zgjedhore, duke qenë se kjo strukturë nuk është më në fuqi.

Ky udhëzim ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 20, pikat 1, shkronja “a”, nenit 29, pikat 5, 6, 7 dhe 8, dhe nenit 36, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,.

Projektakti i propozuar për miratim përmban këto ndryshime:

- në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 5, hiqen fjalët “...ose Zyrrave Rajonale Zgjedhore...” dhe në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 10, hiqen fjalët “...ose Zyrrave Rajonale Zgjedhore...”
- pas pikës 2, të nenit 6, shtohet pika 2.1 , me këtë përmbajtje:

“Me kërkesë të Komisionerit apo Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo shtetas që ka shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtarë apo sekretarë të KZAZ-së”
- pas pikës 2, të nenit 11, shtohet pika 2.1 , me këtë përmbajtje:

“Me kërkesë të Komisionerit apo Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo shtetas që ka shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtarë apo sekretarë të KQV-së.”

Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancave në KZAZ dhe KQV”.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .1.2023

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR.2, DATË 5.12.2020, TË  
KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR ÇAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE  
TRAJNIMIT TË SHTETASVE QË MUND TË EMËROHEN KRYESISHT PËR PLOTËSIMIN E  
VAKANCAVE NË KZAZ DHE KQV”**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja “a”, nenit 29, pikat 5, 6, 7 dhe 8, dhe nenit 36, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

**VENDOSI:**

Në udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 5, hiqen fjalët “...ose Zyrave Rajonale Zgjedhore...”.
2. Pas pikës 2, të nenit 6, shtohet pika 2.1 , me këtë përmbajtje:  
“2.1 Me kërkesë të Komisionerit apo Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo shtetas që ka shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtarë apo sekretarë të KZAZ-së.”.
3. Në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 10, hiqen fjalët “...ose Zyrave Rajonale Zgjedhore...”.
4. Pas pikës 2, të nenit 11, shtohet pika 2.1 , me këtë përmbajtje:  
“2.1 Me kërkesë të Komisionerit apo Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo shtetas që ka shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtarë apo sekretarë të KQV-së.”.

Data: .1.2023 Nr:  
Ora:



“Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 2,  
datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator”

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO**

**Kryetar**

**Arens ÇELA**

**Anëtar**

**Dritan ÇAKA**

**Anëtar**

**Helga VUKAJ**

**Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**

**Anëtar**